

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. FUAT VJERDHA

06/10/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 07.06.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 10.06.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Fuat Vjerdha, kryetar i Gjykatës së Apelit Civil Shkodër.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Olsi Komici, z. Lulzim Hamitaj relator, znj. Pamela Qirko anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.